



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 574 Prot.

Tiranë, më 11. 04. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 93, Datë 11. 04. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën Nr.206 regj, datë 10.10.2023, të paraqitur nga Shoqata “Shpresë për të verbërit”, përfaqësuar nga Presidenti i Shoqatës z.S.F, kundër Bashkisë Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, në inspektimin e rrugës së Durrësit, e cila është rikonstruktuar këto dy vitet e fundit, është konstatuar se nuk është marrë parasysh ligji nr.8098 dhe ligje të tjera të posaçme për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, duke mos vendosur shiritat vizues për të verbërit dhe semaforët akustik. Kjo vështirëson në maksimum aksesueshmërinë e kësaj rruge nga personat e verbër.

Pala ankuese informon se, për këtë problem i janë drejtuar bashkisë me një shkresë në datë 28.02.2023, ku kanë kërkuar informacion mbi projektin e rrugës së Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, nëse në këtë projekt janë parashikuar kriteret për aksesueshmërinë e personave të verbër. Në përgjigjen e datës 01.03.2023 me nr.8560/2 prot, shkresa i është drejtuar për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nga e cila nuk kanë marrë përgjigje.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave që vijnë nga kjo formë diskriminimi.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive. Konkretisht në këtë dispozitë sanksionohet sa vijon: “1. Komisioneri ka kompetencë: ... b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’ a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”.

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata “Shpresë për të verbërit” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur, Shoqata “Shpresë për të verbërit” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në shikim, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në segmentin rrugor, rruga e Durrësit, nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek Zogu i Zi, Bashkia Tiranë.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Shoqata “Shpresë për të verbërit”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, si një bashkim vullnetar i individëve që kanë fituar statusin e të verbërit. Shoqata ka si qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke

vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 206, datë 10.10.2023, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Me shkresën nr. 1073/2, datë 19.10.2023, Komisioneri njoftoi Bashkinë Tiranë për ankesën e paraqitur dhe kërkoi informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e saj, si më poshtë:
  - Kopje të dokumentacionit ligjor dhe teknik mbi përmbushjen e standardeve dhe kriterëve sipas parashikimeve ligjore në fuqi, që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, të segmentit rrugor Rruga e “Durrësit” nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek “Zogu i Zi”.
  - A është i pajisur segmenti rrugor Rruga e “Durrësit” nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek “Zogu i Zi” me shiritat vijëzuese mbi trotuarë për personat me aftësi të kufizuar në shikim? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
  - A janë të pajisur Kryqëzimet në segmentin rrugor Rruga e “Durrësit” nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek “Zogu i Zi” me semaforë akustikë? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
  - Kur është realizuar rikonstruksioni i segmentit rrugor Rruga e “Durrësit” nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek “Zogu i Zi” dhe a janë adresuar aspektet që lidhen me aksesueshmërinë e persnave me aftësi të kufizuara? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
  - Çfarë investimesh janë kryer në 5 vitet e fundit në segmentit rrugor Rruga e “Durrësit” nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek “Zogu i Zi” dhe a kanë prekur këto investimet aspekte që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
  - Çfarë masash janë marrë nga ana e Bashkisë Tiranë për evidentimin e pengesave/barrierave në infrastrukturën rrugore në juridiksionin e Bashkisë Tiranë për personat me aftësi të kufizuar? A është bërë nga ana juaj planifikim i fondeve të nevojshme dhe afateve kohore për

garantimin e aksesueshmërisë në infrastrukturën rrugore për personat me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.

Referuar lajmërim marrjes postare, rezulton se Bashkia Tiranë ka marrë rregullisht dijeni për shkresën e sipërcituar në datën 23.10.2023, por nuk ktheu përgjigje.

3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, si dhe për të administruar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 1073/3 prot., datë 26.12.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 16.01.2024 ora 10:00.

Seanca dëgjimore e datës 16.01.2024, u zhvillua me pjesëmarrjen e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, përfaqësuar nga Presidenti i Shoqatës z. S.F dhe në mungesë të Bashkisë Tiranë, e cila edhe pse referuar lajmërim marrjes së shërbimit postar, ka marrë rregullisht dijeni për datën dhe orën e seancës dëgjimore, nuk u paraqiti dhe nuk paraqiti ndonjë shkak objektiv për mosparaqitjen e saj.

Gjatë seancës dëgjimore, z. F., i qëndroi parashtrimeve të depozituara paraprakisht në ankesë.

Nëpërmjet shkresës për njoftimin e seancës dëgjimore me nr.1073/3 prot., datë 26.12.2023, Komisioneri, rikërkoj nga Bashkia Tiranë që të vendoste në dispozicion informacionin dhe aktet e kërkuara anë të shkresës nr. 1073/2 prot, datë 19.10.2023. Nga ana e Bashkisë Tiranë, pavarësisht se nuk pati përfaqësues në seancë dëgjimore, nuk u depozitua paraprakisht, por as në vijim të seancës dëgjimore, informacioni dhe aktet e kërkuara.

4. Me shkresën nr. 297 prot., datë 14.02.2023, Komisioneri iu drejtua Bashkia Tiranë me një kërkesë të përsëritur për dërgimin e informacionit të kërkuar. Në vijim të kësaj kërkesë, pranë Komisionerit është administruar për dijeni, shkresa nr.7574/1 prot datë 23.02.2024, e Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shërbimeve të Integruara, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë, e cila i drejtohet për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Investimeve të Punëve Publike, Bashkia Tiranë. Në vijim pranë Komisionerit nuk është depozituar anjë informacion nga ana e strukturave të Bashkisë Tiranë.
5. Nëpërmjet urdhrin nr.38, datë 08.03.2024, Komisioneri vendosi kryerjen e një inspektimi në datën 19.03.2024, në segmentin rrugor nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, Rruga e Durrësit, Bashkia Tiranë, me qëllim verifikimin në terren dhe marrjen e informacionit të nevojshëm lidhur me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shikim, të pretenduar në objektin e ankesës (shiritat vijëzues dhe semaforët akustikë) në këtë segment

rrugor. Njoftimi për kryerjen e inspektimit dhe kopja e urdhrin të inspektimit, iu komunikuan Bashkisë Tiranë, me anë të shkresës nr.424/1 prot datë 08.03.2024.

Bazuar në urdhrin nr.38, datë 08.03.2024, të Komisionerit, në datën 19.03.2024, u krye inspektimi në segmentin rrugor nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, Rruga e Durrësit, Bashkia Tiranë, nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Hetimit Administrativ, pranë Zyrës së Komisionerit, gjatë të cilit u mbajt procesverbali i datës 19.03.2024, si dhe u administruar pamje fotografike dhe video, përgjatë gjithë segmentit rrugor objekt inspektimi. Gjatë inspektimit nuk pati përfaqësues nga Bashkia Tiranë, pavarësisht se u njoftuan për datën dhe orën e inspektimit, nëpërmjet shkresës nr. 424/1 prot, datë 08.03.2024 dhe referuar lajmërim marrjes së shërbimit postar rezulton se Bashkia Tiranë ka marrë rregullisht dijeni në datën 11.03.2024, për kryerjen e inspektimit.

Gjatë inspektimit, u konstatua se, në të gjithë gjatësinë e segmentit rrugor të inspektuar, mungonin shiritat vijëzues për personat me aftësi të kufizuar në shikim. Në lidhje me semaforët, gjatë inspektimit u konstatua se, në gjithë gjatësinë e segmentit rrugor ishin të vendosur 3 (tre) semaforë, të cilët ishin të vendosur konkretisht: 1 (një) semafor tek Kryqëzimi te Muzeu, 1 (një) semafor tek Kryqëzimi pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe 1 (një) semafor në afërsi të Gjimnazit “Qemal Stafa”. U konstatua se, akustika e semaforit në afërsi të Kryqëzimit tek Muzeu nuk funksiononte, ndërsa 2 (dy) semaforët e tjerë, nuk rezultuan që të ishin të pajisur me akustikë për personat me aftësi të kufizuar në shikim.

### **III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj për mbrojtjen e anëtarëve të saj që janë persona me aftësi të kufizuar në shikim. Pala ankuese pretendon se, mungesa e aksesueshmërisë (shiritat vijëzues dhe semaforët akustikë) në segmentin rrugor, nga kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, në rrugën e Durrësit, Bashkia Tiranë, diskriminon personat me aftësi të kufizuar në shikim, të cilët për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në këtë segment rrugor, nuk mund të lëvizin dhe të jetojnë në mënyrë të lirë dhe të pavarur.

Bazuar në konstatimet e inspektimit të datës 19.03.2024, rezulton e provuar se në të gjithë gjatësinë e segmentit rrugor nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, në rrugën e Durrësit, Bashkia Tiranë, mungojnë shiritat vijëzues në të gjithë gjatësinë e këtij segmenti rrugor. Nga 3 (tre) semaforë të vendosur në gjithë gjatësinë e këtij segmenti rrugor, semafori në afërsi të kryqëzimit tek Muzeu pavarësisht se në dukje ishte i pajisur me akustikë, nuk ishte funksionale,

ndërsa dy semaforët e tjerë të vendosur në gjatësinë e segmentit rrugor, njëri në afërsi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe tjetri në afërsi të Gjimnazit “Qemal Stafa”, nuk ishin semaforë akustikë.

Bashkia Tiranë nuk depozitoi asnjë dokumentacion apo informacion në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në segmentin rrugor objekt shqyrtimi, të parashikuara nga VKM-të nr.1503/2008 dhe nr. 1074, datë 23.12.2015, apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen.

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, në vijim të një kërkesë që pala ankuese i ka drejtuar Bashkisë Tiranë, kjo e fundit nëpërmjet shkresës nr.S-21202/4 prot datë 15.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, pranë Bashkisë Tiranë, parashtron se: *“ Në lidhje me nyjet semaforike, ju bëjmë me dije se aktualisht 20 kryqëzime nga 83 në total janë të pajisura me sinjalistikën dhe pajisjet përkatëse për personat me aftësi të kufizuar (të verbër). Gjithashtu, Bashkia Tiranë ka në fokusin e saj rritjen e aksesibilitetit për të gjitha kategoritë e popullsisë dhe për këtë arsye të gjitha kryqëzimet e reja që do të pajisen me semaforë janë të planifikuara me sinjalistikën akustike përkatëse. ndërsa në lidhje me shiritat vijëzues mbi trotuarë, ju informojmë se: Në hartimin e projekteve të realizuara nga Bashkia Tiranë, përgjithsisht parashikohet edhe ndërtimi i infrastrukturës së posaçme për personat me aftësi të kufizuar, aty ku trotuarët e lejojnë ndërtimin e saj, sikurse ka ndodhur në projektin e Unazës së Vogël të qytetit.”*

Nëpërmjet një tjetër kërkesë për informacion, pala ankuese i është drejtuar Bashkisë Tiranë, duke kërkuar informacion për projektet urbanistike për disa rrugë, përfshirë projektin për rrugën e Durrësit, nga Kryqëzimi tek Muzeu deri tek Zogu i Zi. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.8560/2 prot datë 21.03.2023, me lëndë *“Për kompetencë”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Bashkia Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, deklarohet se, projekti i kësaj rruge është realizuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, një institucion varësie i Bashkisë Tiranë.

### **Kuadri ligjor i zbatueshëm.**

Neni 23, i Ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* parashikon shprehimisht funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Në pikën 1, të këtij neni parashikohet se: *“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 1. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.....”*

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Tiranë është autoriteti përgjegjës në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen në mënyrë të

drejtpërdrejtë me ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore, etj.

Me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>3</sup>, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>4</sup>. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet,

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

<sup>4</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun; .....

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 4/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare (neni 5/1<sup>5</sup>).

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1074/2015). Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të

---

<sup>5</sup> “Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare”.



*sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat dhe përfshin të gjitha ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët (Kreu I, pika 4).*

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

#### *“PJESA I*

*Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*

#### *Kreu I*

*Të përgjithshme*

#### *Neni 1*

*Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit*

- 1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.*
- 2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*
- 3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:*
  - të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;*
  - godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;*
  - ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;*
  - ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.*

#### *Neni 2*

*Përshtatja e objekteve ekzistuese*

- 1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për*

*përshatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.*

2. *Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.*
3. *Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.*
4. *Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.*

### *Neni 3*

#### *1. Barrierat arkitektonike janë:*

- a) *pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;*
- b) *pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve dhe pjesëve përbërëse;*
- c) *mungesat e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve dhe të burimeve të rrezikut për këdo dhe në veçanti për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.*

8. *Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.*

19. *Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.*

20. *Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.*

21. *Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.*

22. *Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”*

Në Kreun IV, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t'u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e përdorimit të hapësirave të jashtme nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 3, të

VKM së sipërcituar, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në rrugë, të detyrueshme për t'u respektuar. Kështu në pikën 3.1 përcaktohet:

*“Kreu IV*

*Standardet dhe zgjidhjet teknike.*

*3.1 Rrugët.*

- *Vendkalimet për këmbësorët duhet të kenë një gjerësi minimale prej 90 cm, për të lejuar ndryshimin e drejtimit të lëvizjes nga ana personave në karrige me rrota dhe të kenë zgjerime në të njëjtin plan, çdo 10 metra gjatësi.*
- *Çdo ndërrim drejtimi për gjatë rrugës së drejtë duhet të bëhet në të njëjtin rrafsh.*
- *Aty ku është e nevojshme marrja e kthesave 9 00 në drejtim të lëvizjes, vendi duhet të jetë me gjerësi të paktën 170 cm duke filluar nga pika më e jashtme, në të njëjtin plan dhe pa ndërprerje.*
- *Aty ku është e nevojshme të parashikohet një rreth, ky duhet të jetë i ngritur me 10 cm nga toka i realizuar me një material dhe ngjyrë ndryshe nga shtrimi i rrugës, të mos jetë me kënde të theksuara dhe të ndërpritet të paktën në çdo 10 metra nga kalime për në vendet ngjitur të pashtruara.*
- *Pjerrësia gjatësore nuk duhet t'i kalojë të 5%. Nëse nuk është e mundur, lejohen pjerrësi me të mëdha, me kusht që të jenë në përputhje me sa parashikohet në pikën 2.11 të këtij neni.*
- *Në rrugët me pjerrësi të 5% është e nevojshme vendosja e një shesh qëndrimi horizontal, me një hapësirë prej të paktën 150 cm, çdo 15 metra në gjatësi të rrugës. Për pjerrësi më të mëdha gjatësia duhet të zvogëlohet proporcionalisht deri në 10 metra për një pjerrësi 8%.*
- *Pjerrësia maksimale e tërthortë e lejueshme është 1%.*
- *Në prani të kundër-pjerrësisë në fund të një rruge të pjerrët ose të një bashkimi midis kësaj rruge dhe nivelit rrugor, shuma e të dy pjerrësive lidhur me planin horizontal duhet të jetë më e vogël se 22%.*
- *Disnivele optimal mes rrafshit rrugor dhe rrafshit të terrenit ose të vendeve të rezervuara ngjitur me to është 2,5 cm.*
- *Kur trotuari bashkohet me nivelin rrugor ose ndërpritet nga një zonë e rezervuar, lejohen platforma të shkurtra me pjerrësi jo më të madhe se 15% për një disnivel maksimal prej 15 cm.*
- *Deri në një lartësi minimale prej 210 cm nga toka, nuk duhet të ekzistojnë pengesa të asnjë lloji, si tabela sinjalistike ose elementë të dalë nga ndërtesa, që mund të jenë shkak për aksidente për një person në lëvizje.*
- *Ishulli i këmbësorëve duhet të mundësoj përmbushjen e këtyre kushteve:*
- *në rastet kur ishulli i këmbësorëve ndodhet në nivel me rrugën ose niveli i tyre në vendkalim bëhet i njëjtë me nivelin e rrugës, atëherë 15 cm nga fillimi dhe 15 cm nga fundi shënohet vija relievore paralajmëruese me gravurë normal në drejtim të lëvizjes, me gjerësi jo më e vogël se 40 cm, sipas paraqitjes në fig. 38 të shtojcës B të kësaj rregulloreje;*

- në raste kur ishulli i këmbësorëve është i ngritur në krahasim me nivelin e rrugës, kalimi nga rruga në ishullin e këmbësorëve realizohet me pjerrtësi sipas fig. 39 të shtojcës B të kësaj rregulloreje;
- Udhëkryqi i cili ndodhet në zonat e vendbanimeve ku banojnë persona që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar, vendkalimi për këmbësor duhet të ketë semaforin e përshtatur me sinjalizim zanor dhe vijat relievo drejtuese. Vija relievo paralajmëruese realizohet deri te skaji i pjerrtësisë së kalimit në gjatësi jo më të vogël se 110 cm.
- Kur në udhëkryq nuk mund të evitohen pengesat në nivel të njëjtë, realizohen nënkalime ose mbikalime me aplikimin e elementeve përshtatës për arritjen në nivele me lartësi të ndryshme sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- Figura 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41 shtojca B.

3.2. Shtrimet e rrugëve kundër rrëshqitjes realizohet me materiale koeficienti i fërkimit i të cilëve është më i lartë se:

- 0,40 për elementin rrëshqitës lëkurë në shtresë të thatë;
- 0,40 për elementin rrëshqitës gomë e fortë standarde në shtresë të lagur.
- Vlerat e fërkimit të lartpërmendur nuk duhet të ndryshojnë nga vendosja e shtresave lustruese të shtresës së fundit ose të mbrojtjes të cilat nëse vendosen duhet të aplikohen para provës. Hipotezat e kushteve të asfaltimit (e thatë ose e lagur) duhet të merren në bazë të kushteve normale klimaterike të zonës ku do të zbatohet.
- Shtresat mbajtëse të shtrimit duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur për një kohë të gjatë shtrimin dhe mbingarkesën e parashikuar, përveç sigurimit të bllokimit të qëndrueshëm të elementeve përbërës të vetë shtrimit. Elementet përbërës të një shtrimi duhet të kenë nyjzime më të vogla se 5mm, të realizuar me material të qëndrueshëm, të jenë të rrafshët me një trashësi të dukshme jo më të vogël se 2 mm. Hekurat e futura në shtrim duhet të jenë realizuar me hallka të papërshkueshme nga një sferë me diametër prej 2 cm; hekurat me elemente paralele duhet gjithashtu të vendosen me elemente drejtkëndore në drejtim të lëvizjes.”

Në nenet 27 dhe 28, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen standardet teknike që duhet të plotësohen respektivisht, lidhur me rrugët për këmbësor dhe semaforët.

Kështu në Kreun V, në nenet 27 dhe 28 përcaktohet se:

1. Sipërfaqja publike - rruga për këmbësor duhet të jetë:

- i ngritur në krahasim me bordurën së paku 3 cm ose i ndarë me vijë relievo paralajmëruese, e nëse është në nivel të shiritit atëherë ndahet me sipërfaqe rrethore me diametër jo më të vogël se 150 cm;
- i lidhur me sipërfaqet e tjera publike pa pengesë.

Fig. 35 të shtojcës B.

2. *Ndryshimet e nivelit të sipërfaqeve publike – e rrugëve janë të lidhura me njeri tjetrin me elemente përkatës përshtatje për ndryshim të lartësisë. Ato që lidhen me ashensorin e përshtatur ose me platformën ngritëse vertikale, detyrimisht duhet të jenë të lidhura me shkallët e përshtatura.*
3. *Të gjitha pajisjet komunale (banka, tavolina, shenja, shtylla ndriçuese, shportë, mbajtës për biçikletë, panele për reklama dhe të ngjashme) vendosen pranë skajit të sipërfaqes publike – shtegu për këmbësorë, në mënyrë që të mos pengoj personat që nuk shikojnë dhe me shikim të dobësuar.*
4. *Të gjitha ekspozimet në murin e ndërtesës pranë sipërfaqes publike për këmbësorë, si dhe ekspozimet e tjera në këto mure të cilat ndodhen në lartësinë 70 deri 220 cm dhe të dala më shumë se 10 cm, duhet të jenë të realizuara në tërë gjatësinë e tyre deri te sipërfaqja për këmbësorë ose të jenë të shënuara në mënyrë që sipërfaqja e këmbësorëve nën to të jetë e ngritur minimumi 3 cm në krahasim me nivelin rrethues.*
5. *Kur së bashku me sipërfaqet publike të këmbësorëve parashikohet rruga e biçikletave ose parkingu, është e nevojshme realizimi i kufizimit prej sipërfaqeve publike të këmbësorëve me të paktën 3 cm, ose sipërfaqe të gjelbër apo elementë tipike edhe të ngjashëm.*

*Neni 28*

*Semafori duhet të plotësoj këto kushte:*

- *planin relievor i kalimit për në semafor i cili ndodhet në kalimin e rrugës me më shumë se dy korsi të qarkullimit në një drejtim;*
- *sinjalizimin zanor, i cili ndodhet në zonat ku kryesisht qëndrojnë personat që nuk shikojnë dhe me shikim të dobësuar;*
- *sinjalizimi zanor i vendosur në semafor të një drejtimi qarkullues i cili nuk përputhet me sinjalizimin zanor të vendosur në semaforin e drejtimit tjetër qarkullues, te semaforët në udhëkryq;*
- *sinjalizimin zanor i vendosur në semafor, i cili lajmëron vetëm ndërrimin e dritës në semafor;*
- *shpërndarësin e zërit të sinjalizimit zanor i vendosur në semafor, i cili lajmëron personat që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar të cilët kalojnë rrugën.*

Kreu VI, i pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përmban rregullime lidhur me realizimin e rregullave për përshtatjen dhe shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 30, të këtij kreu, parashikohet respektimi i elementëve lidhur me përshtatjen, sipas natyrës dhe qëllimit të objektit/ndërtesës. Në pikën 14, të nenit 30, përcaktohet ndër të tjera se:

*“ Neni 30*

*Respektimi i elementeve të përshtatjes sipas natyrës dhe qëllimit të objektit.*

*Ndërtesat publike, me destincian për ushtrimin e një veprimtarie prodhuese, duhet të projektohen dhe të realizohen duke respektuar rregullat e standardet e përshtatjes të dhëna në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, në përputhje me qëllimin për të cilin ato ndërtohen sipas neneve përkatëse.*

.....

#### *14. Sipërfaqet dhe hapësirat publike:*

- neni: 27 për sheshet e këmbësorëve, rrugët, rrugicat në parqe, lojërat e fëmijëve dhe shëtitoret;*
- neni: 27 për nënkalime, mbikalime dhe ura për këmbësorë;*
- nenet: 8 pika 3.1, 27 dhe 28 për vendkalimet”.*

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, që duhet të përmbushin sipërfaqet publike (rrugët për këmbësorë dhe trotualet dhe semaforët), për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, në rrugën e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, në Bashkinë Tiranë, mungojnë shiritat vijëzues/vijat relievo për orientimin e personave që nuk shikojnë dhe semaforët nuk janë të pajisur me sinjalizim zanor/akustikë për personat që nuk shikojnë. Këto mungesa/mangësi përbëjnë pengesë infrastrukturore dhe nuk lejojnë, pengojnë ose vështirësojnë personat me aftësi të kufizuara në shikim për të lëvizur të lirë dhe të pavarur.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri kërkoi në mënyrë të përsëritur nga Bashkia Tiranë informacion në lidhje me përmbushjen e standardeve dhe kritereve teknike të parashikuara nga VKM nr. 1503/2008. Bashkia Tiranë e la shqyrtimin e ankesës në mungesë dhe pavarësisht kërkesave të përsëritura për informacion të Komisionerit, ajo nuk ktheu asnjë përgjigje.

Bashkia Tiranë nuk paraqiti asnjë dokumentacion apo informacion në lidhje me plotësimin e standardeve teknike të detyrueshme për zbatim në segmentin rrugor objekt i ankesës dhe nuk i kundërshtoi pretendimet e ngritura nga pala ankuese, për mungesën e standardeve të e parashikuara nga VKM nr. 1503/2008, në segmentin rrugor objekt shqyrtimi.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kritereve teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kritereve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët shfrytëzimin e hapësirave publike. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuar, në rastin objekt shqyrtimi të atyre me aftësi të kufizuara në shikim, në hapësirat publike të bashkisë, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju

mohohet e drejta për jetesë të pavarur dhe për të marrë pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, segmenti rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, Bashkia Tiranë, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shikim, e për rrjedhojë Bashkia Tiranë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në shikim. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara në shikim, ndaj një trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe jo të barabartë.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Pala ankuese pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Në nenin 1, të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Referuar nenit 1, të LMD, shkaku i diskriminimit “aftësia e kufizuar” i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD dhe personat që kanë dëmtime ndijore në shikim, janë persona me aftësi të kufizuar.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur**

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte*

*objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollu 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>6</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>7</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>8</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>9</sup>.

Është KDPAK e cila parashikon në nenin 9, të saj të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. KDPAK ndalon gjithashtu çdo formë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, të ndryshuar, “diskriminimi” përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me*

<sup>6</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>7</sup> Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>8</sup> Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>9</sup> Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).



*të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet se ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”*

Në kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, të LMD parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Parashikimet e bëra në pikën 2, të nenit 20, të LMD, janë orientuese dhe jo shteruese. Referuar funksioneve të Bashkisë Tiranë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe përgjegjësisë së bashkisë në ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore, të trotuareve dhe shesheve publike, janë të mira që ofrohen për publikun në përgjithësi dhe janë të mira të cilat hyjnë në fushën e veprimit të nenit 20, të LMD-së.

Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD-së. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin 82, pika 2 të Kodit përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>10</sup>

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga pala ankuese duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

Për sa i përket pyetjes se çfarë e bën një provë *prima facie* të aftë për të zhvendosur barrën e provës tek subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Komisioneri do të mbështetet në parimet e përgjithshme që dalin nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Në çështjen *Baka kundër Hungarisë* (DHM ) (nr. 20261/12, paragrafi 143, datë 23 qershor 2016), GJEDNJ shprehet se: *“Në veçanti, Gjykata miraton konkluzione që, sipas saj, mbështeten nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave, duke përfshirë konkluzionet e tilla që mund të rrjedhin nga faktet dhe parashtruesat e palëve. Prova mund të rrjedhë nga bashkëjetesa e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose të prezumimeve të ngjashme faktesh të pakundërshtueshme<sup>11</sup>”*.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Tiranë, në segmentin rrugor, rruga e Durrësit, Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, nuk ka respektuar standardet e miratuara që duhet të përmbushin sipërfaqet publike, rrugët për këmbësorë, trotualet dhe semaforët, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në shikim. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara në shikim, ndaj një trajtimi të

<sup>10</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>11</sup> Shih: GJEDNJ- Baka kundër Hungarisë (DHM), nr. 20261/12, paragrafi 143, 23 qershor 2016.

padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuar. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara në shikim, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk e kanë këtë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuar në shikim, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkia Tiranë kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuar në shikim, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Sipas KDPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv.

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12). Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: “Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë”.

Vendimi nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në Kreun I, pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se: “9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara”.

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: *“E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambientet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”*.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, Bashkia Tiranë, nuk paraqiti asnjë informacion dhe dokumentacion përpara Komisionerit lidhur me planifikimin e fondeve për përshtatjen/aksesueshmërinë e rrugëve vendore, trotuareve dhe sinjalizimit rrugor për personat me aftësi të kufizuar, përfshi personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve.

Mangësitë në realizimin e aksesueshmërisë në mjedise, shërbime dhe transport për personat me aftësi të kufizuara, janë evidentuar dhe në Planin Kombëtar për PAK 2021-2025, ku në pikën 3.1.1 “Aksesueshmëria fizike”, përshkruhet se: *“Rol dhe përgjegjësi të madhe në realizimin e aksesueshmërisë fizike kanë pushteti vendor. Nga ana e bashkive ka një mungesë të theksuar të zbatimit të VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Bashkia Tiranë nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Në mungesë të dokumentacionit provues në lidhje me hapat konkretë të ndërmarra për të realizuar aksesueshmërinë, Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Tiranë nuk ka marrë asnjë masë për të planifikuar dhe për të realizuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar.

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standardeve minimale që duhet të përmbushen, standarde këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashtuar edhe më sipër në këtë vendim.

Referuar Komentit të Përgjithshëm nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga

KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: “31. Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) kur shërbimi ose objekti është krijuar pas miratimit të standardeve përkatëse të aksesueshmërisë.....”

Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë dhe shërbimet që ofrohen në aksin rrugor që është objekt i ankesës në shqyrtim, si një aks qarkullimi kryesor në Bashkinë Tiranë, Komisioneri vlerëson se, rruga e Durrësit, nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, është një segment rrugor me frekuencë të lartë të frekuentimit në jetën e përditshme nga qytetarët, ndryshe nga rrugë të tjera dytësore që në varësi të pozicionit dhe shërbimeve që ofrohen, mund të mos lindi nevoja që të frekuentohen në mënyrë të përditshme. Rezulton se në gjatësinë e këtij segmenti rrugor janë të vendosura dhe ofrojnë shërbime të përditshme shumë institucione publike dhe private që ofrojnë shërbime kryesore të nevojshme për banorët e këtij qyteti si: Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucione arsimore, institucione financiare, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore etj. Për të funksionuar në mënyrë efektive dhe të sigurt në punë, arsim dhe jetën e përditshme, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses fizik në të njëjtat hapësira, punësim, mallra, shërbime dhe pjesëmarrje në komunitet, si të gjithë qytetarët e tjerë.

Pavarësisht se nga ana e Bashkisë Tiranë nuk u vendos në dispozicion asnjë informacion në lidhje me investimet e realizuara në këtë segment rrugor, është një fakt i njohur publikisht se, rikonstruksioni i segmentit rrugor objekt shqyrtimi, është bërë vitet e fundit. Komisioneri konstaton se, Bashkia Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike<sup>12</sup> që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eleminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t’a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi

<sup>12</sup> VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshëm është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: “duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar<sup>13</sup> dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar<sup>14</sup>”.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në segmentin rrugor, rruga e Durërsit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, të Bashkisë Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara në shikim, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se, nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Tiranë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në shikim në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara në shikim. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se, trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara në shikim, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të lmd, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD,

<sup>13</sup> Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

<sup>14</sup> Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Tiranë nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shikim. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Bashkisë Tiranë, i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në shikim, nga ana e Bashkisë Tiranë, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, Tiranë.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Tiranë, të marrë masa të menjëhershme për:
  - a. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*” dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”.
  - b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha rrugëve vendore, trotuarëve dhe sinjalizimit rrugor, për të cilat nevojitet aksesueshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Aftësi e kufizuar  
Fusha: Të mira dhe shërbime/Aksesueshmëri  
Lloji i vendimit: Diskriminim